



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Pranuar - Primiteno Më/Dana <u>28-09-2016</u>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
	<u>01-014/1210</u>		

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d.) dhe neni 40 paragrafi 2 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 35 paragrafi 2 pika b) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës: 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën: 28.09.2016 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2017-2019

I

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2017-2019.

Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 është në shumë prej 10,019,298 €. Buxheti për vitin 2018 është në shumë prej 10,262,299 €. Buxheti për vitin 2019 është në shumë prej 10,466,701 €.

II

Burimet e buxhetit janë: Të hyrat nga Grandi Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2017 janë:

- a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar8,912,603 €
b) Të hyrat vetanake komunale1,106,695 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2018 janë:

- c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar9,155,604 €
d) Të hyrat vetanake komunale1,106,695 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2019 janë:

- e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar9,345,997 €
Të hyrat vetanake komunale1,120,704 €

Buxheti për vitin 2017 shpërndahet në këto kategori ekonomike :

- Paga e mëditje.....6,928,119 €
Mallra e shërbime 953,534 €
Shpenzime komunale 200,862 €
Subvencione dhe transfere197,712 €
Shpenzime kapitale..... 1,739,071 €

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa,
2. Shërbimit të Kuvendit
3. MAPL
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

